



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission

Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission

27-10-2020

Prishtinë / Priština

Nr./Br. 985-2020

Në bazë të autorizimeve të dhëna me neni 10 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-040 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 nën paragrafi (c), nenin 65.2 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 6 dhe 7 të udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 27.10.2020, nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **Z.Ismet Hajrizi** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri, nga subjekti politik "Lidhja Demokratike e Kosovës-LDK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z.Agron Përçuku.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z.Ismet Hajrizi dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

### Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 21.10.2020, nr.985/2020, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal z.Agim Përçuku, pas dorëheqjes së tij të parevokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, për arsye të zgjedhjes në pozitën e drejtorit për inspektim në komunën e Vushtrrisë.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar, se kandidati i radhës në listën e rirënditur është, z.Ismet Hajrizi i cili ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit si kandidat i radhës, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 27.10.2020

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

  
**Valdete Daka**  
Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Prishtinë  
Priština